



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:982/26 Datë: 19.06.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 150 të mbajtur më 08.06.2026, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimeve të Kolegjit Universum në kampusin kryesor në Prishtinë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):
 1. *Inteligjenca Artificiale në Biznes, Bachelor Profesional, 170 ECTS; me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
 2. *Juridik, LLM 60 ECTS; me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji Universum që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Universum të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Universum brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inteligjenca Artificiale në Biznes, Bachelor Profesional, 180 ECTS;</i>	Qëndrim Hykaj Hana Kastrati Musliu Shqipe Abazi Ilirjana Hajrullahu
2.	<i>Juridik, LLM 60 ECTS;</i>	Fitim Gashi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Universum.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Inteligjenca Artificiale në Biznes, Bachelor Profesional, 180 ECTS*; vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 25.03.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; *Juridik, LLM 60 ECTS*; vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 06.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Substancialisht shtatë (7) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 150-të, të mbajtur më datë 08.06.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Universum dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekipi i ekspertëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Universum;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

